

Thirrja nga data 18.06.2025 deri në datën 20.06.2025

TERMAT E REFERENCËS PËR AKOMODIMIN NË HOTEL PËR NXËNËSIT NGA KOMUNA E PRIZRENTI, GJAKOVËS DHE FUSHË KOSOVËS NË KUADËR TË AKTIVITETIT TË SHKOLLËS VERORE

Organizata	OJQ "NEVO KONCEPTI"
Objektiva	Akomodim në hotel për nxënës të shkollave partnere të komunave Prizren, Gjakovë dhe Fushë Kosovë, për pjesëmarrës në Shkollën Verore e cila cili organizohet në kuadër të projektit "Fuqizimi i komuniteteve të cënueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës".

OJQ "Nevo Koncepti" është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ "Nevo Koncepti" kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në formë të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin pozitës së komunitetit rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikur se në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj

OJQ "Nevo Koncepti" bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

Aktualisht OJQ "Nevo Koncepti" është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian.

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

Projekti "Fuqizimi i komuniteteve të cënueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës" financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim, Save the Children Kosova/o (SCiK) dhe partnerët e saj të projektit synonë të fuqizojë vajzat dhe djemtë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian me njohuri, kapacitet, aftësi dhe mundësi për të kaluar në moshën madhore, si dhe me punë dinjitoze, të denjë dhe të qëndrueshme. Duke përfshirë shtatë komuna në Kosovë, projekti përdor një strategji me shumë nivele që përfshin ndërhyrje në nivelin e fëmijës dhe familjes, shkollës, komunës, tregut të punës dhe në nivel kombëtar OJQ Nevo Koncepti nga tetori 2023, ka filluar të zbatojë projektin "Fuqizimi i komuniteteve të cënueshme të Kosovës përmes qasjes më të mirë dhe të barabartë në tregun e punës" në Komunën e Prizrenit, Gjakovës dhe Fushë Kosovës.

Projekti është i shtritur në dymbëdhjet shkolla në tre komunat e cekura më lartë, nga ky numër në gjashtë shkolla fillore të mesme të ulta dhe gjashtë shkolla të mesme të larta profesionale. Kryesisht aktivitetet e projektit janë në lidhje me fuqizimin e nxënësve të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në vazhdimsinë e shkollimit, orjentim në karrierë dhe përgaditje e qëndrueshmërisë në tregun e punës.

2. OBJEKTIVA

OJQ “Nevo Koncepti” është në kërkim të një hoteli që plotëson kushtet e nevojshme për organizimin e Shkollës Verore me nxënësit e klasave VI-IX nga shkollat partnere të komunave Prizren, Gjakovë dhe Fushë Kosovë, si më poshtë:

- ShFMU “Haziz Tola” – Prizren
- ShFMU “Mati Logoreci” – Prizren
- ShFMU “Zef Lush Marku” – Gjakovë
- ShMU “Yll Morina” – Gjakovë
- ShFMU “Selam Riza” – Fushë Kosovë
- ShFMU “Daut Bugujevc” – Fushë Kosovë

Shkolla Verore është planifikuar të mbahet në rajonin e Prevallës (komuna e Prizrenit), për të ofruar një ambient natyror më tërheqës dhe stimulues për nxënësit pjesëmarrës.

3. KUSHTET QË DUHET TË PLOTSOHEM PËR KËTË AKOMODIM

Hoteli duhet të ofrojë kushte të përshtatshme dhe të sigurta për nxënësit pjesëmarrës në Shkollën Verore, si dhe për stafin dhe vullnetarët.

Konkretisht, kërkohet që:

- Të ketë hapësira të mjaftueshme dhe të sigurta për zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara, brenda ose jashtë objektit.
- Të ofrojë dhoma të rehatshme dhe të përshtatshme për akomodimin e nxënësve, stafit dhe vullnetarëve.
- Të mos ketë aparate funksionale për shitjen e produkteve të duhanit në ambientet e hotelit.
- Të mos shërbehet alkool për asnjë pjesëmarrës gjatë gjithë kohës së qëndrimit.

4. REZULTATET E PRITSHME

- **Zhvillim i suksesshëm i Shkollës Verore në ambient të përshtatshëm dhe të sigurt**
Hoteli ofron mjedis të qetë dhe të përshtatshëm për aktivitete edukative, çlodhëse dhe rekreative për nxënësit, duke kontribuar në një përvojë të pasur mësimore jashtë klasës.
- **Akomodim cilësor dhe i organizuar për të gjithë pjesëmarrësit**
Sigurimi i dhomave të rregullta, të pastra dhe të rehatshme për nxënësit, stafin dhe vullnetarët, me ndarje të përshtatshme sipas gjinisë dhe numrit të pjesëmarrësve.
- **Mjedis i sigurt dhe pa elemente të dëmshme për fëmijët**
Hoteli respekton kërkesën për ndalimin e shitjes së produkteve të duhanit dhe mos-shërbimin e alkoolit, duke ofruar një ambient të sigurt dhe të shëndetshëm për të miturit.

- **Mbështetje logjistike dhe bashkëpunim profesional nga stafi i hotelit**
Stafi i hotelit bashkëpunon ngushtë me organizatorët për nevoja të ndryshme teknike dhe praktike gjatë zhvillimit të programit, si orari i ushqimit, përdorimi i hapësirave, ndihma emergjente etj.
- **Sigurimi i tri vakteve ditore të plota**
Nxënësit, stafi dhe vullnetarët do të kenë në dispozicion mëngjes, drekë dhe darkë, të shërbyera në kohë dhe me cilësi të lartë gjatë gjithë ditëve të qëndrimit në hotel.
- **Ushqim i balancuar dhe i përshtatur për fëmijët**
Menytë ditore do të përmbajnë ushqime të larmishme, të pasura me vlera ushqyese, të përshtatshme për moshën dhe aktivitetet e nxënësve, duke shmangur ushqimet e përpunuara apo me shumë sheqer e yndyrë.
- **Përmbushja e kërkesave të veçanta dietike**
Hoteli duhet të jetë i gatshëm të ofrojë opsione alternative për pjesëmarrës që mund të kenë kufizime ushqimore për arsye shëndetësore, fetare apo preferenca personale (p.sh. ushqim vegjetarian).
- **Standard i lartë i pastërtisë dhe higjienës në përgatitje dhe shërbim**
Përgatitja e ushqimit dhe shërbimi në ambientet përkatëse do të bëhet në përputhje me standardet e sigurisë ushqimore, duke garantuar një mjedis të pastër dhe të kontrolluar.
- **Shërbim korrekt dhe i koordinuar me orarin e aktiviteteve**
Vaktet do të jenë të organizuara në përputhje me agjendën ditore të Shkollës Verore, për të mos penguar rrjedhën e aktiviteteve dhe për të siguruar kohë të mjaftueshme për ngrënie të qetë dhe të rregullt.

5. AFATI KOHORË I AKOMODIMIT

Akomodimi i nxënësve do të realizohet si vijon:

- **01 – 04 korrik 2025:** Akomodim i plotë në hotel, që përfshin mëngjesin, drekën, darkën dhe fjetjen.
- **05 korrik 2025:** Dita e fundit e qëndrimit, gjatë së cilës do të sigurohen vetëm mëngjesi dhe dreka.

6. INFORMACIONE PËR PAGESËN

Nevo Koncepti do të paguaj Hotelin përzgjedhës bazuar në faturën e lëshuar pas përfundimit të Shkollës Verore.

Nevo Koncepti do të kryejë pagesën përmes transferit bankar në llogarinë bankare pas përfundimit të Shkollës Verore.

7. PROCEDURAT E APLIKIMIT

Të gjithë Hotelet e interesuara duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

- a) Oferta.
- b) Të ofroj dokumentin e ARBK-s me informacione rrethë kompanis aplikuese.
- c) Të ofroj dokumentin e personit juridik/drejtorin/menagjer të agjencisë turistike.
- d) Të sigurohet dokumenti i drejtorit/menagjerit të kompanis nga Gjykata i cili/la nuk është nën hetime.

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 20.06.2025** në email: prokurimi@nevokoncepti.org apo në formë fizike në selin e OJQ''Nevo Koncepti'' në adresën Rr.Adnan Krasniqi nr.149, hyrja II Nr.8 Prizren.